

# DETAJE

Gazetë e publikuar nga OSBE-ja

Edicioni 3 Nr. 5 Nentor - 2003

## Palët e interesuara takohen për të luftuar trafikimin me njerëz

Shumë vajza, madje edhe 11 vjeçare, dhe gra trafikohen sot në dhe për rreth Kosovës. Si ta luftojmë trafikimin me njerëz në Kosovë ishte pyetja të cilën u munduan ta adresojnë 300 persona të kualifikuar nga Kosova dhe Ballkani në një konferencë të mbajtur kohëve të fundit.

Nga Hana Kranston



Mjete të rëndomta të përdorura për trafikim ndërkuftar

Tregimi për një 13 vjeçare, e kidnapuar jashtë shkollës së saj dhe vazhdimisht e dhunuar nuk ishte i këndshëm. Pasi e kishin droguar, dhunuar, fotografuar lakuriq dhe pasi ishte kërcënuar nga një njeri me çekan në dorë, ajo nuk kishte guxim t'i tregonte familjes së saj. Shokuese, por gjithsesi jo e jashtëzakonshme. Këtë muaj, në konferencën e Kosovës kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, gjyqtarë, punëtorë social, policë, specialistë të drejtave të njeriut, prokurorë, qeveritarë dhe shumë të

tjerë që punojnë për ta luftuar trafikimin me njerëz, diskutuan në mënyrë aktive mënyrat se si t'i parandalonjë këto përvoja dhe si t'i ndihmojnë viktimat e trafikimit në të ardhmen.

Konferenca e mbajtur në Prishtinë është organizuar në bashkëpunim me OSBE-në, institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes, departamenti i drejtësisë së UNMIK-ut, IOM-i, UNICEF-i dhe OJQ-ve lokale dhe ndërkombëtare. Konferenca kishte për qëllim vazhdimin e punës, rritjen e dialogut dhe ko-

ordinimit në mes të grupeve relevante në mënyrë që të nxirren rekomandime të cilat do të mund të përfshiheshin në një plan veprues të Kosovës, të udhëhequr nga zyra e kryeministrit. Pjesëmarrës ishin zyrtarë e grupit punues të Paktit të Stabilitetit mbi trafikimin me njerëz, Zyra e OSBE-së për institucione demokratike dhe të drejta të njeriut (ODIHR), Amnesty International, Euro-poli, Iniciativa Rajonale e Evropës Juglindore kundër trafikimit me njerëz dhe përfaqësuesit e OJQ-ve lokale dhe ndërkombëtare.

### Të kuptuarit e trafikimit

Kosova është vend tranziti por edhe destinacion, si dhe vend i origjinës për trafikim me njerëz. Kështu që, viktimat kosovare dhe të huaja trafikohen nëpërmes, brenda dhe nga Kosova. Sot, gjithnjë e më shumë gra dhe vajza joshen ose kidnapohen brenda Kosovës, pastaj ose dërgohen në ndonjë vend të Evropës Juglindore ose trafikohen diku brenda Kosovës. Sipas Dr. Helga Konrad, kryesuese e

grupit punues të Paktit të Stabilitetit mbi trafikimin e qenieve njerëzore, 67% të viktimave të ndihmuara në Kosovë këtë vit kanë qenë kosovare dhe 32% e tyre kanë qenë prej moshës 11 deri në 14 vjeç.

Gra dhe fëmijë të prekur nga varfëria dhe papunësia, që mbizotërojnë këtu, veçanërisht në pjesët rurale, janë pre e trafikantëve. Ofertat për punë, posaçërisht jashtë vendit, janë joshëse për ato që nuk mund ta ushqejnë veten ose fëmijët e tyre, dhe më shumë trafikantë përdorin femra që flasin gjuhën e

vendit për të joshur gratë të bëhen skllave. Për këtë arsye, është me rëndësi që njerëzit të kujdesen për njëri-tjetrin, posaçërisht nëpër fshatra dhe komunitete të vogla, të jenë vigjilent dhe të shpërndajnë fjalën se duhet të jenë të vetëdijshëm për trafikantë grabitës që ofrojnë punë.

### Parandalimi duhet të fillojë në shtëpi

Problem i përgjithshëm në Kosovë përsa i përket trafikimit është mungesa e mirëkuptimit

Vijon në faqen e dytë



Salla përplot pjesëmarrës në konferencën e Kosovës kundër trafikimit me njerëz

### KIENËMËR

OSBE-ja mbështet rolin e të rinjve

faqe 3

Kthimi i qëndrueshëm kërkon përkushtim

faqe 4

Na jepni mundësi të barabarta

faqe 6

Mediat mbi trafikimin

faqe 7

OSCE

## "Gjyshe, puthe shtëpinë tonë!"

Nga Olivera Stojanović

Branka Ugrinović është njëra nga 50 të kthyerit në fshatin Sreckë, Komuna e Prizrenit. Ajo na tha, "nipat dhe mbesat e mija kanë lindur në këtë fshat, mirëpo tani janë në Novi Sad. Kur isha duke u kthyer, ata më thanë, "gjyshe, puthe shtëpinë tonë në Sreckë." Branka na tha se për të është shumë e rëndësishme që është kthyer.

Srecka është një fshat malor që ishte braktisur nga serbët e Kosovës në vitin 1999. Edhe përkundër shkatërrimit dhe infrastrukturës së kufizuar, ai ka një paisazh madhështor që të lë pa frymë. Tani, katër vite më vonë, pasi që kaluan një kohë në qendra të ndryshme kolektive nëpër tërë Serbinë dhe Malin e Zi, disa familje kanë vendosur të kthehen.

Aleksandar Softiq, 81 vjeçar, ishte i ndër të parët që u kthye në fund të vitit 2002 dhe tani

është "udhëheqës i fshatit". Ne e takuam atë deri sa ai po shkonte në një mbledhje të komunitetit dhe na tha, "ato që ne i gjetëm këtu ishin vetëm gërmadha, mirëpo rindërtimi filloi shpejt përmes ndihmave. Tani për tani, gjithçka është mirë, por shpresoj se gjithnjë e më shumë të rinjë do të kthehen së shpejti".

Ata të cilët janë kthyer nuk ngurojnë që të shprehin kënaqësinë për kthimin e tyre. Në Serbi kanë pasur siguri më shumë, mirëpo jeta larg Sreckës, ku ata kishin lënë gjithçka që kishin pasur, nuk ishte e këndshme. "Të jesh mbi të 50-tat dhe t'i vësh të gjitha sendet që i ke fituar gjat gjithë jetës në dy çanta shpine dhe t'ia fillosh nga e para nuk është lehtë," thotë ai. "Ne patëm një jetë normale më parë, por tani ne duhet që t'ia fillojmë sërish të kërkujmë që nga tavolina dhe enët e deri tek hekuri e

karrigat" konkluduan ata.

Ndër të kthyerit më të vjetër është gjyshja Jefimija 91 vjeçare. Ajo na tha se është kthyer për shkak të shtëpisë dhe restorantit që ata e kishin pasur. "Nuk kisha se ku të shkoja tjetërkund dhe biri im e rinovoi shtëpinë tonë", tha plaka duke pëshpëritur dhe shtoi, "është shumë më mirë në fshatin tim se çdokund tjetër".

Ditët mund të jenë të gjata kur nuk ke se çka të bësh, por fshatarët thanë se, "aktivitetet siç është mirëmbajtja e kopshtit, përgatitja e ëmbëlsirave si dhe vizita në fshat ndihmojnë". Megjithëse rrallë, disa fshatarë të Sreckës kanë udhëtuar edhe jashtë fshatit dhe janë takuar me fqinjët e vjetër shqiptarë, të cilët u thanë se janë të mirëseardhur.

Përshtypja e përgjithshme në fshat është se punët po ecin përpara. Megjithatë, në fshat as

nuk ka shkollë e as shitore, si dhe puna në shtëpi të shëndetit nuk është kompletuar ende. Me siguri se kushtet nuk do të jenë të mjaftueshme që t'ua mundësojnë fshatarëve që të qëndrojnë aty gjatë këtij dimri. Banorët e Sreckës shprehan se sa i egër është dimri malor dhe thanë se ata thjesht nuk mund të qëndrojnë aty gjatë dimrit pa ujë, pa rrymë dhe dru për zjarrë.

Përkundër kushteve të papërshtatshme, fshatarët kanë shpresuar për një kthim masovik. OSBE-ja dhe shumë organizata ndërkombëtare e përkrahin fuqishëm procesin e kthimit, duke theksuar se çdonjëri që dëshiron të kthehet duhet që t'ia bëjë atë nëse kushtet janë të duhura. Shumë të kthyer dëshirojnë që të shohin një kthim normal në fshatin e tyre dhe shpresojnë se kjo do të ndodhë me kalimin e kohës.



Nga Helga Konrad,  
Grupi Punues i Paktit të Stabilitetit, Vienë

## Një hap drejtë luftimit të trafikimit

Është ndërmarrë një hap i rëndësishëm drejt ndërtimit të një kornize solide në të cilën duhet të kordinohen përpjekjet rajonale dhe vendore për të luftuar trafikimin me njerëzëve. OSBE-ja në Kosovë ka organizuar "Konferencën Kundër Trafikimit të Njerëzëve", të mbajtur prej 20 deri më 23 tetor, ishte një ngjarje me rëndësi e cila bashkoi akterët kryesor në përpjekjet e Kosovës për ta luftuar trafikimin dhe për të diskutuar elementet e një plani të fuqishëm aksional kundër trafikimit. Kjo veçanërisht tani është e rëndësishme, pasi që në duhet të përipiemi të bëjmë

më shumë kundër trafikantëve të cilët vazhdojnë të kryejnë këtë krim nëpër Evropën Juglindore pa u ndëshkuar. Qeveritë e vendeve në rajon duhet të rizotohen për të punuar me OJQ-të vendore, të sigurojnë kujdes domethënës dhe siguri për viktimat e trafikuar, që të kenë mundësi të shërohen. Autoritetet për zbatimin e ligjit dhe OJQ-të duhet të punojnë së bashku të themelojnë lidhje efektive dhe bashkëpunim. Përveç kësaj, fakti se ka shenja se trafikimi mbrendshëm dhe trafikimi me fëmijë dhe të mitur është në rritje e sipër në rajon dhe në Kosovë, tregon se sa e rëndë

sishme është t'ju qasësh këtyre vendeve me kujdes dhe me një strategji specifike. Lidhur me këtë, është inicuuar takimi i parë me nëngrupin e Kosovës për trafikimin e fëmijëve, dhe shpresohet se së shpejti do të formalizohet nga koordinatorët qeveritar. Zotimi dhe energjia e atyre që organizuan dhe morën pjesë në këtë konferencë ishte domethënëse, dhe Grupi Punues i Paktit të Stabilitetit për trafikimin e njerëzëve në këtë konferencë e çmon lartë punën e tyre, dhe është optimiste se në këtë drejtim do ketë rezultatet pozitive për Kosovën dhe Evropën jug-lindore.

### Vijon nga faqja e parë

dhe gatishmërisë për të diskutuar për këtë problem. Kjo shpesh në izolimin e viktimës nga familja e saj dhe komuniteti pas kthimit të tyre në shtëpi, duke iu bërë të vështirë rintegrimimin në jetë dhe punë. Gratë e trafikuar i nënshtrohen torturës fizike dhe mentale, të cilat i lënë ato shpesh me pasojë psikologjike. Viktimat e trafikimit janë skllave dhe nuk kanë zgjidhje në atë se çfarë iu ndodh atyre pasi të jenë shitur. Kosova ka përdorimin më të lartë të metodave detyruese të trafikimit në Evropën Juglindore, siç është rimbimi me dhunë.

Sidoqoftë, Nime Sherifi, koordinatore për antitrafikim në Qendrën për Mbrojtjen Grave dhe Fëmijëve tha se "fatëkeqsisht, në Kosovë respekti për viktimat e trafikimit është i ulët për momentin." Gjendja e viktimave zakonisht rrjedh si pasojë e dëshpërimit dhe për këtë arsye duhet të shikohet si një problem social i përgjithshëm e jo si dështime individuale.

Aksioni i parë kundër trafikimit duhet të fillojë në nivel të vendit. Me 30% të viktimave në Kosovë nga familjet problematike, është e qartë se parandalimi duhet të fillojë në shtëpi. Familja duhet të jetë mbrojtja më e madhe që një person mund ta ketë. Nuk mund të mohohet se Kosova ka një ekonomi të varfër dhe dëshira për migrim është e madhe, por nevoja për të braktisur shtëpinë do të ishte më e vogël sikur të kishin jetë familjare stabile, të barabartë dhe të dashur.

### Lufta kundër trafikimit

Sa i përket parandalimit të trafikimit, konferenca ka dhënë sqarime të shumta për përmirësimin e metodave të luftimit të trafikimit. Habit Hajredini, drejtor i zyrës për qeverisje të mirë, të drejtave të njeriut, mundësi të barabarta dhe çështjeve gjinore, bëri apel për më shumë shkëmbim të informatave me njësinë e hetimit të trafikimit dhe prostitucionit pranë UNMIK-ut. Ai gjithashtu foli për adresimin e shkaktarëve të trafikimit si p.sh.

kërkesën për shërbime seksuale në Kosovë.

Florije Pajaziti nga organizata "Shpëto Fëmijët" (Save the Children), foli për më shumë trajnim për fëmijët në shkollat të mesme dhe promovim të situatave të vetëdijësimit në rajonet rurale, që janë caku parësor për autorët e trafikimit.

Në përgjithësi, pjesëmarrësit ishin të pajtimit se të gjitha ministrat, organizatat dhe OJQ-të duhet të punojnë për një koordinim më të ngushtë që të arrijnë rezultate gjithëpërfshirëse dhe parandaluese.

Këshilla e Dr. Konradit ishte se, "Qeveritë nacionale duhet të zbatojnë masa efektive për luftimin e trafikimit. Kjo është përgjegjësi e tyre dhe ata duhet të përkrahen nga grupet tjera." Ajo sugjeroi që të emërohet koordinatori i qeverisë kosovare që të punojë me ministrat dhe ky grup punues ndërmirator duhet t'i përfshijë të gjitha organizatat tjera relevante të lartë-përmendura.

Rekomandimet tjera përfshijnë trajnime të zgjeruara për policë, gjykatës dhe prokurorë ashtu që kjo çështje të trajtohet me ndjeshmërinë që e meriton.

Gjithashtu është arritur pajtimi që pasi viktimat të jetë identifikuar nga policia, ajo duhet të merret në përkujdesje nga OJQ-të, të cilat mund t'i sigurojnë asaj strehim, fshetësi, këshilla ligjore dhe ta shtojnë nivelin e inkurajues të mirëkuptimit, sa më shpejt që është e mundur.

Shumë pjesëmarrës theksuan nevojën e rritjes së nivelet të sigurisë dhe mbrojtjes së viktimave.

U këshillua se ligji mbi trafikimin (Rregullorja e UNMIK-ut 2001/4) duhet të zbatohet më fuqishëm; sipas këtij ligji personat që paguajnë për shërbime seksuale nga një femër e trafikuar mund të dënohen deri më 15 vjet burg, trafikantët deri më 20 vjet burg, ndërsa viktimat nuk do të ndiqen penalisht. Gjyqet dhe ligjet e reja penale që do të hyjnë në veprim vitin e ardhshëm duhet të marrin parasysh procedurën e standardi-

zuar të statusit dhe mbrojtjen e viktimave, mbylljen e lokaleve që përdoren për prostitucion të femrave të trafikuar dhe konfiskimin e mjeteve.

### Trafikimi është problem madhor në nivel njerëzor

Pasquale Lupoli, kryesues i IOM-it në Kosovë, qartësoi kuptimin e përgjegjësisë kolektive kur deklaroi se, "trafikimi është problem madhor në nivelin njerëzor, sepse ai jo vetëm që prek ata njerëz që janë zënë në kurth, por është problem për të gjithë ne." Përdorimi i femrave të trafikuar për qëllime seksuale mund të shtojë paratë dhe fuqinë e grupeve kriminale të organizuara si dhe të kontribuojë në krijimin e rrejtëve tjera të drogës dhe armëve në Kosovë, gjë që shton jostabilitetin në mjedis. Shfrytëzimi i shërbimeve të prostitucionit të detyruar gjithashtu mund të përhap sëmundje seksualisht të transmetueshme.

Në sajë të kësaj konference, Kosova mund të shpresojë në masa të vazhdueshme dhe përmirësuar kundër trafikimit. Zëvendësi i shefit të misionit të OSBE-së në Kosovë, Rolf Van Uye, shpalli çështjen e futjes kundër trafikimit si "çështje tepër prioritare për organizatën, ashtu siç tregon plani veprues i OSBE-së për luftim të trafikimit, i miratuar kohëve të fundit nga Këshilli i Përhershëm."

Paul Coffey, drejtori i departamentit të drejtësisë pranë UNMIK-ut shtylla I, theksoi se nëse fenomeni i trafikimit do të referohej fjalë për fjalë si "torturim, kidnapim dhe robërim," interesimi i opinionit publik do të ishte shumë më i madh se deri më tani. Trafikimi është një shpërdorim i turpshëm dhe i patolerueshëm i të drejtave të njeriut. Për një rajon që shpreson që një ditë të bëhet pjesë e Evropës, është e domosdoshme që Kosova të veprojë kundër këtij krimi të neveritshëm njëherë e përgjithmonë.



DEAE  
DEALS  
DEALI

Rruga Beograd 32 38000 Pristina  
Tel. (+381-38) 500 162 Fax: (+381-38) 500 188  
E-mail: press@omik.org

Botuesi:  
Sven Lindholm  
Kryeredaktor:  
Charlotte Granville-Ross

Redaktorë:  
Hasan Sopa (Detaje)  
Slavica Mladenovic (Detalji)

Diserji & faqesja  
Shpend Kada

Bashkëpunëtorët:  
Srdjan Antic, Edita Buraj,  
Hannah Carston, Chris Cymancnik,  
Afrone Çitaku, Mustafa Eric,  
Arjan Haxhibaqiri, Arben Hajredinaj,  
Xhemë Ibraj, Rexhep Krasniqi,  
Fatime Lepaja, Inderim Pasull,  
Gezim Rexha, Halide Sadiku,  
Olivera Stojanovic, Mervyde Sallhu,  
Mustafa Skenderi, Slavica Staletovic,  
Besnik Tahiri, Armand Tahirsylaj,  
Irfan Ukshini, Bernard Vrbani

OSCE  
Mission in Kosovo

Shënim:  
Pikëpamjet e paraqitura apo prezantimi i materialeve të botuara nuk shprehin politikën, opinionin apo qëndrimet e misionit të OSBE-së në Kosovë.

# Më shumë përkrahje për të rinjtë

Mjeshtri shqiptar i penës Faik Konica ka thënë se të rinjtë në këtë pjesë të botës, për fat të keq, është dashur "të piqen para kohe". Kjo është posaçërisht e vërtetë për fëmijët kosovarë. Shumë prej tyre është dashur të ngriten në këmbët e veta dhe të sillen si të rritur shumë më herët se bashkmoshatarët e tyre në vendet tjera.

Nga Edita Buçaj

## Të investosh në rini - investon në ndryshime

Duke qenë grupi më i madh demografik, të rinjtë në Kosovë kanë treguar një vullnet të fortë që të jenë më të përfshirë dhe të japin kontributin e tyre në zhvillimin e politikave. Do të jenë padyshim gjeneratat e reja ato të cilat do t'i japin shtytje proceseve, për të arritur deri të rezultatet dhe ndryshimet që ata duan t'i shohin. Shpresohet se asambletë e të rinjëve do të jenë të suksesshme dhe në këtë aspekt OSBE-ja nuk ka hezituar të ofrojë ndihmën e saj.

Në fillim të tetorit të këtij viti, të rinjtë e Gjilanit dhe Lipjanit u mbledhën për të zgjedhur udhëheqësinë e asamblesë së tyre shumëtnike - të parën e këtij lloji. Një projekt i ngjashëm do të sponsorohet dhe implementohet edhe në qytetin e Mitrovicës.

"Vendimet tuaja do të jenë të rëndësishme për komunitetet tuaja, pra për ata që ju përfaqësoni," tha znj. Edit Kovacs, Zyrtare për Demokratizim pranë OSBE-së në hapje së takimit.

## Rolet dhe qasjet

Sipas statutit të Asamblesë së Rinisë, në kuadër të komunës,



Të rinjtë nga Gjilani duke votuar me rastin e themelimit të asamblesë rinore.

asambletë do të jenë përgjegjëse për katër fusha (për të cilat parashikohen të themelohen edhe komisionet përkatëse). Këto fusha janë: arsimi, kultura dhe sporti; ekologjia dhe mbro-

jtja e ambientit; asistencë sociale për të rinjtë me nevoja të veçanta dhe gjithashtu menaxhimi dhe kontrolli i buxhetit, bazuar në ligjet që rregullojnë secilin aktivitet.

## Përbushja e standardeve demokratike

Përveç elementit të shumë-eticitetit, asambleja e rinisë ka punuar edhe në sigurimin e barazisë gjinore. Kryetarja e

zgjedhur në mënyrë demokratike e Asamblesë së Gjilanit, znjsh. Arbëresha Rrahmani nuk ishte zgjedhur vetëm pse ishte femër. Ajo kishte marrë vota prej përfaqësuesve të dy gjinive. Në fjalimin e saj të parë në cilësinë e kryetares, ajo u zotua, "të bëjë çmos për të përmirësuar kushtet e jetesës për banorët e komunës tonë."

"Është nevojë urgjente që të merremi me çështjen e ambientit. Ajri që ne e thithim është plot pluhur e smog." Homologu i saj nga Lipjani u zotua se do të luftojë pirjen e duhanit dhe dukuritë tjera të shëmtuara tek të rinjtë

## Betimi

"Unë solemnisht deklaroj se do të kryej të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë si një anëtar/e i/e ndershme i/e Kuvendit Komunal, në mënyrë të paanshme, me ndërgjegje dhe në pajtim me ligjin, me qëllim që të siguroj kushte të favorshme për një jetë të qetë për të gjithë," ishin fjalët të cilat të gjithë anëtarët i thonin me admirim.

Gjatë këtyre takimeve të para të gjithë dukeshin të entuziazmuar, megjë të rinjtë e bashkësive të ndryshme gjetën një gjuhë të përbashkët - diçka që mungon tek të rriturit.

# Vazhdon dialogu civil

Nga Besnik Tahiri

Dialogu Civil është inicuar nga Shoqata Nëna Tereze (SHNT) në Kosovë dhe nga Qendra për Rajonalizim në Novi Sad (QR), me ndihmën e Misionit të OSBE-së në Kosovë dhe zyrës së Fondacionit të Shtëpisë së Lirisë (FSLH) me seli në Beograd. Qëllimi është që të ndihmojnë, përkrahen dhe të udhëheqin aktivitetet e projekteve të veçanta që kanë për qëllim: zhvillimin e formave të komunikimit civil, bashkëpunimin rajonal, kthimin e besimit, bashkëpunimin dhe bashkëpunimin me qëllim të tërheqjes së interesimit të qytetarëve drejt procesit të pajtimit si dhe normalizimit e marrëdhënieve ndërmjet komuniteteve.

Plani i veprimit të Dialogut Civil për vitin 2004 është zhvilluar që nga mbajtja e mbledhjes së suksesshme e OJQ-të e të rinjve nga Kosova dhe Serbia në maj të vitit 2003 dhe nga konferenca rajonale "Ndërtimi i partneriteteve dhe rjetave rajonale" në qershor të këtij viti në Prishtinë.

Në takimin e fundit të mbajtur

në Beograd në tetor të vitit 2003, këshilli për 'Dialog Civil' definoi planet e ardhshme dhe projektoi strategjinë për zgjerimin e aktiviteteve në vitin 2004, duke u bazuar në aktivitetet e mëparshme dhe angazhimet rajonale. Këshilli propozoi aktivitete konkrete, duke theksuar se me fillimin e dialogut formal ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit, janë hapur mundësi të reja për përfshirjen e shoqërive civile të cilat duhen të merren në shqyrtim për t'i situar përpjekjet.

Këshilli për 'Dialog Civil' propozoi udhëheqjen e aktiviteteve të dedikuara opinionit publik në bashkëpunim me media, për t'a rritur rolin e OJQ-ve dhe akterëve tjerë civil në negociatat e sponsoruara nga Kombet e Bashkuara ndërmjet qeverive të Prishtinës dhe Beogradit, nepërmjet publikimeve, lobimit dhe ngjarjeve publike.

Pos anëtarëve të këshillit për Dialog Civil morrën pjesë edhe z. Fridhelm Frishenshlager, drejtori i departamentit për demokratizim pranë OSBE-së dhe Mihajl Steresiniq, drejtori i FS-



Këshilli për dialog civil gjatë një takimi të tyre.

HL-së në Serbi. Z. Frishenshlager tha se OSBE-ja me të vërtetë i çmon lartë përpjekjet e Qendrës për Rajonalizim dhe të SHNT-së dhe se OSBE-ja do të jetë e interesuar të vazhdojë partneritetin me FSHL në përkrahje të Dialogut Civil.

Një nga anëtarët e këshillit, Dr. Jovan Komsiq, tha, "le të fillojmë me temat më pak kontraverse dhe të ndikojmë në opinionin publik duke organizuar takime me individë publikë nga Kosova dhe Serbia, në

qëllim që t'i tregohet opinionit publik se negociatat ndërmjet strukturave politike janë duke u zhvilluar. Kjo gjithashtu do të kontribuonte në drejtim të ndërtimit të besimit dhe normalizimit të marrëdhënieve në rajon."

# Kthimi i qëndrueshëm kërkon përkushtim

Edhe, përkundër përpjekjeve të pa reshura të bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë, përfshirë këtu edhe OSBE-në, por edhe përpjekjet e faktorit vendorë, vështirësitë dhe problemet me të cilat ballafaqohen të kthyerit janë ende të shumta. Ato mund të radhitën që nga strehimi, ushqimi, veshmbathja, suguria e lëvizjes, punësimi e deri te kushtet më elementare të jetës.

Nga Hasan Sopa



Shtëpitë e të posakthyerve në pritje të rëndërtimit

Në fillim të këtij viti, pikërisht më 22 mars 2003, pas shumë përpjekjesh dhe peripetish u bë i mundur edhe kthimi i grupit të parë të shqiptarëve në fshatin Biti e Epërme, komuna e Shtërpçës, të cilët që nga konflikti jetuan aty ku mundën dhe si mundën.

## Jeta nën qiellin e hapur

Për shumicën nga ne e hëna e 13 tetorit ishte një ditë e zakonshme. Rrallë ndokuj mund t'i ket ndodhur diçka e veçantë. Por për banorët e Bitisë së Epërme ajo ishte një ditë e shenuar. Atë ditë atyre po u shpërndahej një kontigjent me veshmbathje dhe ushqime, që ata aq shumë kishin nevojë.

Për dikënd mbase kjo nuk është fare interesante. Shumë nga ne i kemi harruar ato skena që dikur ishin përditshmëri e

jona. Tani ato më nuk janë në shënjestër të mediave, ngase sipas tyre nuk janë lajme senzacionale. Por për 46 familje, sa janë kthyer momentalisht në këtë fshat, kamioni me ndihma të dhuruara, nga një organizatë gjermane 'Lachen Helfen' do të thotë shumë. "Siç po e shihni ne jetojmë nën qiellin e hapur", na tha i brengosur z. Shyqeri Hamiti i cili është edhe përgjegjës i këtij fshati.

Për shpërndarjen e ndihmave ishte kontraktuar një shofer i nacionalitetit serb me komionin e tij, Z. Mark Kalmbah, zyrtar i lartë për demokratizim në zyrën e OSBE-së në Shtërpçë shpjegon, "në fillim kishte hezitim nga ana e shoferit, mirëpo meqë 50% e ndihmave ishin shpërndarë më parë për banorët serbë, nuk ishte edhe aq vështirë".

## Kthimi nën mëshirën e fatit

Nuk ka dyshim se këtyre njerëzve por edhe të gjithë atyre që ende janë të shpërngulur i'u është mërzitur jeta prej refugjati. Por edhe kthimi nën mëshirën e fatit nuk është i lehtë. Kjo vrehet më së miri në fytyrat e brengosura të të kthyerve. "Nevoja më urgjente për ne është strehimi. Dimri po vejen e ne ende jemi nën tenda. Nëse ndihmat në material ndërtimor, që na janë premtuar, nuk sillen më shpejtë nuk dimë çka do të ndodh me ne" thotë z. Hamiti.

## Shpresat ende nuk janë humbur

Një projekt i përbashkët i Komitetit Amerikan për Refugjat, që bënë konceptin e përgjithshëm të projektit, Grupit Punues të Kuvendit Komunal të Shtërpçës, përgjegjës për kordinimin e projektit dhe OSBE-së, përgjegjëse për gjetjen e fondëve, pritet të realizohet së shpejti.

Për të mësuar më tepër rreth këtij projekti ne biseduam me z. Horst Denecke, shef i zyrës së OSBE-së në Shtërpçë. "Javën e ardhshme priten të sillen disa ndihma në material ndërtimor në fshatin Biti e Epërme. Vlera e përgjithshme e projektit është rreth 1.9 milion Euro. Mirëpo meqë prrojeksi nuk mund të realizohet këtë vit në tërësi, atëherë ai është ndarë në faza. Në fazën e parë përfitues janë 27 familje, shtëpitë e të cilave janë të kategorisë së pestë. Të kësaj kategorie janë 24 shtëpi

të banorëve shqiptarë dhe 3 shtëpi të serbë të varfur të Bitisë së Poshtme

Sipas z. Denecke, për fazën e parë janë siguruar 500.000 Euro nga buxheti i konsoliduar i Kosovës, zyra për kthim dhe komunitete. Fondi do ta ndihmohet pjesërisht edhe nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP) si dhe Komiteti Danez për Refugjat.

## Megjithatë ka pakënaqësi

Mirëpo e gjithë kjo nuk kalon pa probleme. Banorët shqiptarë të Bitisë së Epërme, na thanë se ishte paralajmëruar bllokimi i rrugës nga banorët serbë të Bitisë së Poshtme ditën kur do të sillleshin ndihmat. Rruga ishte bllokuar edhe kur banorët shqiptarë tentuan të kthehen për herë të parë në fillim të këtij viti.

Sipas z. Denecke, banorët serb kanë shprehur shqetësimin e tyre dhe ai vjen si rezultat i pakënaqësisë së banorëve serbe me mënyrën e distribuimit të ndihmave. "Ne u munduam t'ua shpjegojmë atyre, përshkak se dimri po afrohet, prioritet kanë banorët shqiptarë, shtëpitë e të cilëve janë tërësisht të rrënuara dhe kur projekti të realizohet në tërësi ata padysim do ta marrin pjesën që u takon", shprehet z. Denecke dhe beson se një zgjidhje do të gjindet dhe ndihmat do të shkojnë, sa më parë që është e mundur, aty për ku edhe janë nisur.

Kthimi nuk është një proces i lehtë. Gjithësesi kërkon një angazhim serioz të të gjithë atyre që drejtpërdrejt merren me te. Por edhe shoqëria kosovare në tërësi mund ta ndihmoi këtë proces.



Ndihmat u shpërndahën të kthyerve në Biti të Epërme

# Fitues ishte shoqërimi në mes komuniteteve

Ngjarjet sportive po e përforcojnë pajtimin dhe rinteprimin

Nga Zillha Nurkollari & Kujtim Paqaku



Anëtarë i ekipit fitues duke pranuar shpërblimin e fituar

Ka shumë çështje që kanë të bëjnë me romë dhe që kërkojnë intervenime afatgjata. Disa projekte, të inicuar prej OJQ-ve, janë duke u treguar të sukseshme në shumë çështje të romëve, përfshirë këtu pajtimin dhe rinteprimin dhe janë shembuj të shkëlqyeshëm për ardhmëri.

Një turne futbollit i romëve, ashkalinjëve dhe egjiptiasve ishte një iniciativë e sukseshme e organizuar nga "Iniciativa 6", një OJQ romë, në bashkëpunim me Forumin Rinor të Partisë Demokratikë të Ashkali-njëve Shqiptar dhe e përkrahur nga departamenti për demokratizim pranë OSBE-së në Prizren dhe Departamenti i Kulturës dhe Sportit.

Një të diele të kthjellët, brohoritjet e simpatizuesve shpërthyen në stadiumin e Prizrenit për ekipet e futbollit që morën pjesë në turne. Shoqërimi në mes të lojtarëve dhe simpatizuesve ishte i qartë për të gjithë dhe

ishte një fakt për suksesin e këtij projekti.

"Qëllimi i këtij projekti ishte që t'i bashkojë të rinjtë shqiptarë me ata të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptasë për një ngjarje sportive", tha z. Osman Ismani, përfaqësues i "Iniciativa 6". "Ky turne futbollit ka parë vazhdimin e procesit për bashkimin e të rinjëve të komuniteteve të ndryshme me qëllim që të ndërmeret procesin e pajtimit".

12 ekipet që morën pjesë në këtë turne treguan saktësisht atë që është shpresuar, një shoqërim të lehtë dhe respektimin e njëri tjetrit. Që nga fishkëllima e parë e gjyqëtarit e deri në fishkëllimën e fundit, aty kishte më shumë brohoritje sesa gola.

Ashtu siq ishte planifikuar, tri ekipet fituese u shpërblen, mirëpo, fituesi më i madhë ishte shoqërimi i komuniteteve.

# Ngritja e kuadrove dhe bashkëpunimi

Nga Biserka Ivanoviq

Ishte një mundësi e mirë për disa individë për tu takuar, të shkëmbejnë përvoja dhe të mësojnë nga njëri-tjetri kur 75 aktivistë të OJQ serbe të Kosovës u takuan në "Konferencën e OJQ-ve vendore për ngritjen e aftësive dhe bashkëpunimit". Në hapje të konferencës, Ambasadori i OSBE-së, Pascal Fieschi theksoi se, "është i nevojshëm një bashkëpunim pragmatik në mes të të gjitha komuniteteve si dhe një angazhim ndëretnik që do të kontribuoj për një Kosovë të vërtetë shumetnike."

Përfaqësuesit e OJQ-ve serbe nga të gjithë regionet e Kosovës ishin mbledhur në një konferencë me përfaqësuesit e komunitetit ndërkombëtar (OSBE, UNHCR, Këshillit të Evropës, zyrtarë të UNMIK-ut për të zhvendosurit dhe Medicos del Mundo). Në këtë ngjarje ishte edhe një përfaqësues i OJQ-ve të shtipitarëve të Kosovës, Këshilli për

Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNI).

Pjesëmarrësit e shfrytëzuan mundësinë për t'i ndarë mendimet e tyre lidhur me zhvillimin e një strategjie për të ardhmen, në sektorë të ndryshëm të shoqërive civile. Posaçërisht ata diskutuan hapat të cilët duhet të ndërmerren për të siguruar një bashkëpunim efikas në mes të sektoreve, dhe një rrjedhë më të mirë të informimit dhe bashkëpunimit në mes komuniteteve. Secili tregoi një entuziazëm admirues dhe përfshirje në diskutime grupore si dhe u dhanë shumë ide konstruktive. Një ide interesante erdhi nga aktivistët e OJQ-së së serbëve të Kosovës të cilët dëshirojnë të shohin komunitetin ndërkombëtar më të hapur ndaj ideve dhe sugjerimeve të vendorëve. Ndihej se një rrjedhë më e mirë e informacioneve ishte e duhur në mes të sektoreve të ndryshëm, (donatorëve dhe OJQ-ve).

Përfaqësuesit e OJQ-ve të serbëve të Kosovës gjithashtu theksuan nevojën e vetëorganizimit më të mirë në angazhime dhe aktivitete të përbashkëta. Ata e konsideruan këtë konferencë si një hap shumë të rëndësishëm drejt bashkëpunimit në të ardhmën më aktëretë e organizatave të tjera ndërkombëtare.

Një nga rekomandimet e dëgjura në konferencë ishte nevoja që OSBE-ja të jetë më transparente. Aktivistët e OJQ-ve të serbëve të Kosovës gjithashtu kërkuan që të kenë trajnime profesionale të mbajtura nga ekspertët kompetent si një pjesë e ngritjes së kapaciteteve dhe zhvillimit të tyre profesional. Kohëve të fundit, departamenti për demokratizim i OSBE-së e përmirësoj bazën e të dhënave të OJQ-së të serbëve të Kosovës dhe këto informacione së bashku me rezultatit e diskutimit të grupit, rekomandimet dhe syzjerimet nga kon-

ferenca, do të shpërndahen në një broshurë në të 3 gjuhët (anglisht, shqip dhe serbisht).

Ambasadori Fieschi i'u tha pjesëmarrësve, "OJQ-të e kanë mundësi të marin rolin udhëheqës për t'iu treguar politikanëve se si një dialog në mes komuniteteve mund të bëhet rutinor dhe reciprokisht i dobishëm për

të gjitha komunitetet." Ambasadori gjithashtu theksoi nevojën që zërat e aktivistëve të OJQ-ve të serbëve të Kosovës të dëgohen dhe mirëkuptohen. Ai përsëriti pikëpamjet dhe idetë konstruktive, duke shpresuar së komuniteti ndërkombëtar do të rris përkrahjen në punën e mirë që po bëjnë shoqatat e OJQ-ve.



Konferenca mbi shkëmbimin e përvojave në ngritjen e kuadrove të OJQ-ve lokale

# Detyra për modernizimin e mediave në Kosovë

Nga Mustafa Erik

"Po kthehemi nga kjo konferencë me ide të reja dhe kjo është me rëndësi," tha Kelmend Hapqiu, kryeredaktor i agjencisë së lajmeve KosovaLive, i cili kryesoi delegacionin e parë kosovar që mori pjesë në një mbledhje konsultative ndërkombëtare të organizuar nga Shoqata Botërore e Gazetave (ShBG).

Ngjarja e mesit të tetorit, "Tryeza e Rrumbullakët për Menaxhimin e Shoqatës së Gazetave," ka bashkuar përfaqësuesit nga vendet tjera të Evropës Juglindore siç janë Rumania, Bullgaria dhe Shqipëria. Qëllimi kryesor i kësaj tryeze të rrumbullakët ka qenë t'iu bëjë të mundur pjesëmarrësve nga mediat e shkruara t'iu ndajnë përvojat në forcimin e shoqatave të tyre përmes aksioneve të përbashkëta para qeverive të tyre. Udhëtimi i delegacionit të Kosovës për në Pragë për këtë ngjarje është sponsoruar dhe financuar nga Misioni i OSBE-së në Kosovë (OMiK), si pjesë e mandatit të saj për të përkrahur ndërtimin e institucioneve në Kosovë.

Zyra për Përkrahjen e Media pranë departamentit për demokratizim të OSBE-së ka qenë e përfshirë në një përpjekje gjithëpërfshirëse për të konsoliduar skenën mediale në mënyrë që gazetat dhe mediat elektronike të mund të funksionojnë si agjentë të vërtetë të "Fuqisë së Katërt", siç quhen mjetet e informimit publik në demokracitë funksionale.

Trajnimet mbi gazetarinë kanë qenë veçori dalluese të këtyre përpjekjeve gjatë këtyre viteve. Zyra për Trajnim pranë Sektorit për Media të departamentit për

demokratizim zhvillon 15 deri në 20 programe në vit, për t'iu dhënë mundësinë gazetarëve të Kosovës për të përmirësuar shkathtësitë e hulumtimit dhe të shkrimit, si dhe shkathtësitë për prodhimin e radio dhe TV programeve të një standardi më të lartë.

Kohëve të fundit, trajnimi është përqëndruar në shkathtësitë menaxhuese për t'ia bërë të mundur mediave ekzisitese të konsolidojnë pozitën e tyre duke arritur vetë-qëndrueshmërinë në tregun e vogël të Kosovës.

Programi i OMiK-ut për përkrahjen e mediave gjithashtu synon t'iu jap komuniteteve etnike në Kosovë mundësinë të kenë qasje në informata të sakta, objektive dhe në kohë në gjuhën e tyre përmes projekteve të ndryshme. Një përpjekje me rëndësi që e vlen të përmendet në këtë fushë është rrjeti i 28 radio stacioneve serbe të Kosovës, të shtrira në tërë Kosovën, e cila pritet të përfundojë së shpejti. Nën projektin e financuar nga Agjencia Evropiane për Rindërtim (AER) dhe implementuar nga OMiK-u, të gjitha 28 stacionet do të jenë në gjendje të emetojnë lajme të përbashkëta dhe programe të aktualiteteve para përfundimit të vitit 2003. Projekti nuk ka injoruar kualitetin që i nevojitet gazetarisë dhe gjithashtu ka siguruar trajnim sistematik për të punësuarit në radio stacione përmes përfshirjes së Qendrës Evropiane për Gazetarinë Transmetuese (QEGT), një institucion me seli në Beograd dhe e udhëhequr nga BBC-ja.

Sa i përket bashkëpunimit ndërrajonal, ekipi për përkrahjen



Mediat në veprim

e mediave pranë OMiK-ut ka qenë shumë aktiv që nga fillimi i këtij viti. Shumë konferenca, seminare dhe takime janë organizuar për të sjellë së bashku përfaqësues nga disa vende të Evropës Juglindore, për të kontribuar në themelimin e raporteve profesionale dhe zgjerimin e tolerancës dhe mirëkuptimit në mes të mediave të rajonit. Një përpjekje e spikatur ka qenë konferenca e organizuar në muajin maj nga Organizata e Mediave e Evropës Juglindore (SEEMO), anëtare e Institutit Ndërkombëtar të Shtypit (IPI), e cila ka bashkuar kryeredaktorët dhe redaktorët e mediave nga Serbia dhe Kosova.

OMiK-u ka financuar dhe lehtësuar pjesëmarrjes e përfaqësuesve të mediave të Kosovës në këtë ngjarje. Një takim pasues do të organizohet në Shkup para përfundimit të vitit. Brenda kontekstit të bashkëpunimit rajonal, projekte të ndryshme për romë dhe komunitetet tjera, dhe projekte që kanë për qëllim trajnimin e grave gazetare dhe themelimin e shkëmbimit të programeve për fëmijë, janë duke u zhvilluar ose veç janë implementuar.

Edhe pse është bërë mjaft, mbetet shumë për tu arritur. Mbetet shumë punë për tu bërë deri në pëmbushjen e detyrës për ndër-

timin e institucioneve në fushën e mediave para se rregulloret adekuate të hyjnë në fuqi për një ambient ku mjetet e informimit mund të funksionojnë plotësisht si roje efikase në të mirë të publikut. Derisa Komisioni i Përkohshëm për Media përgaditet të bëhet Komisioni i Pavarur për Media, ekziston një nevojë e veçantë për një organ vetërregullues për mediat e shkruara dhe për një kod të mirësjelljes. Asambleja e Kosovës duhet të diskutojë dhe miratojë një sërë dekretesh legjislative për të rregulluar çështjet e të drejtave të autorit, transmetimin publik dhe privat dhe temat kundërshtuese si etiketimi dhe shpifja.

Rregulloret e reja për mjetet e informimit, duke përfshirë zvogëlimin e mundshëm të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) në shitjen e gazetave dhe rregulloret e mundshme për të qeverisur transmetimin kablovik janë disa nga çështjet tjera kryesore që presin të diskutohen. Trajnimin i gazetarëve të cilët janë në mesin e karrierës do të duhet t'iu transerohet partnerëve kosovar, në mënyrë që këto aktivitete do të bëhen nga institucionet vendore, derisa shkollimi akademik i gazetarëve duhet të jetë i institucionalizuar me plan-program adekuat dhe staf akademik.

Perspektiva për pëmbushjen e këtyre detyrave është premtuese: stafi i OMiK-ut dhe bashkësisë ndërkombëtare është i dedikuar, dhe brenda skenës mediale të Kosovës ekziston mirëkuptim, me disa përjashtime, se këto qëllime duhet të arrihen nëse Kosova dëshiron të bëhet pjesë e Evropës siç dëshiron.

# Barazia gjinore

Nga Patrik Hofman



Duke mësuar mbi barazinë gjinore

Javën e kaluar është mbajtur një seminar mbi vetëdijësimin gjinor për burra dhe gra në komunën e Lipjanit dhe Glllogocit. Seminari kishte për qëllim ngritjen e vetëdijes për të drejtat e femrave në mënyrë që të siguroj punësim të barabartë, dhe të përmirësoj bara-

zinë gjinore në institucionet demokratike dhe në aktivitetet tjera kryesore.

Pesëdhjetë e katër pjesëtar të komunitetit ashkali, serb dhe shqiptar të Kosovës morën pjesë në seminar, i cili siguroi trajnim mbi çështjet e femrave siç janë, gjinia, nevojat gjinore dhe

rrjedhat e përgjithshme gjinore në shoqëri.

Hysni Sefa, një mashkull ashkali nga fshati Vrellë në komunën e Lipjanit mësoi gjëra të reja mbi barazinë gjinore, "unë shpresoj që secili mashkull që ka marrë pjesë në seminar do të filloj të zbatoj këshillat të

cilat i kemi dëgjuar. Për mua si një mashkull ka qenë shumë e dobishme ndjekja e këtij trajnimi, si edhe për femrat ashkali, sepse ato kanë mësuar si të mbrojnë të drejtat e veta në të ardhmen."

Trajnimitin e mbajti Qendra për Trajnime dhe Huluntimë Gjinore në Prishtinë. Qëllim ishte që të ju mundësoj pjesëmarrësve të të tri komuniteteve të ndryshme etnike nga të dy komunat, të ekzaminojnë dhe zhvillojnë iniciativat në mënyra të ndryshme, duke i përmirësuar aftësitë e tyre për të integruar vetëdijësimin gjinor në planifikim, politikë, programe dhe praktikë.

Qëllimi i këtij seminari ishte që pjesëmarrësit të pajisen me njohuritë bazë, se paragykimin gjinor është pengesë e vërtetë drejt një zhvillimi të qëndrueshëm demokratik. Ai më tej e ka shtuar mirëkuptimin mbi vetëdijësimin gjinor, dhe si të zhvillohen ai në të gjitha vepërimtaritë e veta si një vegël e çmuar në ndërtimin e një demokracie të qëndrueshme. Trajnimi ka siguruar që barazia gjinore të merret parasysh në të gjitha aspektet e planifikimit të programeve dhe se një barazi

e duhur gjinore është arritur në të gjitha nivelet e vendimarrjes.

Xhyste Dabaj, zyrtare për çështje gjinore në komunën e Lipjanit tha, "vetë numër i pjesëmarrësve në të dy ditët tregon se trajnimi ishte shumë i suksesshëm dhe se ata kanë qenë të kënaqur me përmbajtjen dhe organizimin e seminarit. Ky seminar gjithashtu e ka forcuar rolin tim si zyrtare për çështje gjinore pasi që unë isha përgjegjëse për të fuar pjesëmarrësit."

Një koleg i Znj. Dabaj nga komuna e Glllogocit tha, "edhe pse unë e pata ndjekur një seminar mbi barazinë gjinore në komunën time, unë përsëri fitova njohuri të reja dhe do të shfrytëzoj në punën time të ardhshme."

Përshtypja e përgjithshme ishte se trajnimi ishte i organizuar mirë dhe se individët shprehën një interesim për ta ndjekur një seminar tjetër në të ardhmen e afërt. Në fund të seminarit, ishin ndarë certifikata për pjesëmarrësit të cilët me krenari deklaruan se barazia gjinore tani më ka filluar dhe se askush nuk mund ta ndal

## Na jepni mundësi të barabarta

"Që një person të jetë i suksesshëm, pa marrë parasysh ku punon dhe jeton, është shumë më e rëndësishme që ai të i ipet mundësia e pranimit dhe integritetit në shoqëri."

- thotë Gëzim Rexha, monitorues i mediave në Misionin e OSBE-së në Kosovë -

Nga: Fatime Lepaja

Në mesin e tre mijë personave me pamje të kufizuara, është një djalosh i gjatë, i pashëm dhe shumë inteligjent, Gëzim Rexha nga qyteti i Gjakovës, në jugperëndim të Kosovës. Gëzimi ka diplomuar në degën e gjuhës dhe letërsisë angleze në Universitetin e Prishtinës dhe punon me OSBE-në që nga viti 1999.

Kur filloi të punojë me OSBE-në, shefi i zyrës së OSBE-së në Gjakovë Dan Sejmor e pyeti Gëzimin se çka i nevojitej atij në mënyrë që të kryej punën me sukses. Gëzimi kishte lexuar se ekzistonin mjete elektronike, por asnjëherë nuk kishte pasur rast që ato pajisje t'i përdorë në praktikë. Së shpejti filloi procedura për sigurimin e pajisjeve, dhe Gëzimi menjëherë filloi të kryejë punën si media monitor, së pari në OSBE në Gjakovë dhe pastaj në Prishtinë.

Katerina Artelli atëherë koordinatore rajonale për media pasiqi përfundimit të misionit i ndihmoi Gëzimit duke ia dërguar një kopje origjinale të programit 'Qasje në Punë me të Folur'. Ky program i mundëson personave me pamje të kufizuara që të përdorin plotësisht kompjuterin me anë të të folu-



Gëzim Rexha, monitorues i mediave, misioni i OSBE-së në Kosovë

rit dhe me audio mekanizëm. Sistemi u mundëson këtyre personave të lexojnë, shkruajnë, redaktojnë dhe kryejnë të gjitha operacionet që mund t'i kryejë secili person tjetër. Më vonë OSBE-ja i ofroi edhe një program tjetër të quajtur 'VIRGO' që do të thotë 'Mbulim i Plot me Grafikë' që i mundëson Gëzimit të lexojë dhe dërgojë e-mail-a. Duke i përdorur të dy programet dhe me ndihmën e një specialisti nga Viena, ai mund të kryejë detyrat e tij pa

vështërsi.

"Të jesh i verbër do të thotë se ke nevojë shtesë dhe vështërsi të natyrave të ndryshme," na tregon Gëzimi, "por ato vështërsi nuk janë të pakalueshme, dhe unë mund t'i tejkaloj ato duke përdorur teknika alternative, në mënyrë që të arrijë rezultat të njëjti si të tjerët."

Gëzimi është anëtar i 'Shoqatës së të Verbërve dhe atyre me Pamje të Kufizuara', dhe kohëve të fundit është zgjedhur si përfaqësues i Kosovës për këtë shoqatë.

Më 15 tetor ishte 'Dita Ndërkombëtare e Njerëzëve me Shkop të Bardhë', prandaj ne e pyetëm Gëzimin se sa munden institucionet vendore t'i mbështesin personat me nevojë të veçanta? Ai na tregoi, "të gjithë në Kosovë, duke përfshirë edhe ata me nevojë të veçanta, e kuptojnë se mundësitë dhe kushtet e institucioneve tona në përgjithësi janë të kufizuara që të bëjnë më shumë, kjo është arsyeja që ne nuk mund të presim shumë. Por çka ne do kërkonim prej tjerëve është që të lirohen nga paragykimet, sepse vet paragykimet dhe qëndri-

met negative krijojnë më shumë vështërsi se vet verbëria.

Si person i verbër ju mund të keni aftësitë dhe kualitetet e nevojshme për të kryer një punë specifike, të ndjekësh një shkollë, por thjesht për shkak të paragykimeve juve nuk ju ofrohet mundësia. Për këtë arsye, ne do të kërkonim nga të tjerët të, "na japin mundësi të barabarta". Kjo do të ishte edhe motoja jonë.

"Përvoja ime personale është mjaftë pozitive dhe unë e çmoj faktin se në OSBE çdoherë jam

prirë mirë dhe jam i trajtuar në mënyrë të barabartë. Personalisht nuk ndihem i diskriminuar as pozitivisht as negativisht, ndonëse besoj se edhe diskriminimi pozitiv mund të të lëndojë," tha Gëzim Rexha.

Gëzimi na tregoi se si njerëzit me nevojë të veçanta munden të integrohen në shoqëri dhe punojnë me kapacitet normal. Tash është një detyrë e shoqërisë që personat me pamje të kufizuara t'i pranojë dhe t'u ofrojë mundësi që të jenë të suksesshëm siç është padyshim Gëzimi.

Gëzim Rexha në ambientin e tij të punës



# Mbulimi medial i trafikimit me njerëz në Kosovë

Nga Arben Hajredinaj

Gjatë muajit tetor u organizua dhe u mbajt një konferencë tre-ditore për luftimin e trafikimit me qenie njerëzore, organizuar nga Zyra për Mbështetje dhe Këshillim të Viktimave. Para kësaj konference, zyra e OSBE-së për trajnimin e mediave pranë departamentit për demokratizim, organizoi dhe mbajti një takim të shkurtër pune mbi 'Mbulimin Medial të Trafikimit me Qenie Njerëzore'. Si një fenomen negativ në Kosovë dhe në tërë regjionin e Europës Juglindore, trafikimi me qenie njerëzore është rritur vazhdimisht, sidomos gjatë katër viteve të fundit. Në fillim njerëzit nuk dinin shumë për këtë temë ose asgjë. Përgjegjësia e vetëdijësitit të njerëzve lidhur me trafikimin bie veçmas në organizatat joqeveritare dhe qeveritare, të cilat përmes fushatave për ngritje të vetëdijes, trajnimeve, seminarëve mblodhën aktivistë nga nivele të ndryshme lokale dhe ndërkombëtare që të debatoheshin dhe të mundoheshin t'i tejkalonin problemet e trafikimit në regjionin e Kosovës.

Trafikimi u paraqit si një problem i madh në kohën kur nuk ekzistonin metoda parandalimi dhe nuk ekzistonin njësitë për

hulumtime të kimit në mënyrë që të gjejnë dhe arrestojnë personat e përfshirë në trafikim me qenie njerëzore. Sot, organizata të ndryshme kanë krijuar raporte statistikore dhe kanë publikuar harta të klubeve të natës, restoraneve e kafiterive që janë të ndaluara për personelin e tyre ndërkombëtar dhe lokal për shkak të statusit të tyre të dyshimtë që ka të bëjë me trafikim të qenieve njerëzore. Megjithatë, shumica e popullatës ende kanë qasje në këto vende. Si një fenomen i ri, prostitucioni është nxitës për disa të rinjë në Kosovë - dhe harrojnë se shumica e këtyre grave dhe vajzave janë sjetllur me dhunë nga vende tjera apo janë kidnapuar dhe trafikuar përbrenda Kosovës.

Gjatë tërë kësaj kohe mediat kosovare, posaqërisht televizionet të cilat konsiderohen si medimet më të fuqishme në Kosovë, shumë pak kanë raportuar për ndonjë ngjarje hulumtuese që ka të bëjë me riatdhesimin e të mbi-jetuave të trafikimit. Të shumtën e rasteve ato mbështeten në deklaratat zyrtare të organizatave të ndryshme që luftojnë trafikimin me qenie njerëzore. Prandaj, ekziston një mosnjohje e diturisë kolektive që mbërthen

në vete luftën kundër trafikimit si dhe kontekstin përbrenda të cilit trafikimi shfaqet.

Së voni, mediat malazeze dhe kosovare raportuan se si një polic i zakonshëm arrestoi kriminelin më namëkeq dhe më të kërkuar Dilaver Bojku, një shqiptar nga Maqedonia i përfshirë në rrjetet e kimit të organizuar, duke përfshirë kështu edhe trafikimin me qenie njerëzore, dhe atë jo vetëm në Ballkan por edhe në Europë. Kjo tregon se vetëm me përkushtim ky fenomen mund me të vërtetë të çrrënojset dhe ndalet po që se policia ndërkombëtare dhe lokale punojnë më shumë dhe më me seriozitet për ta luftuar krimin e organizuar në Kosovë.

Në kontekstin e kimit të organizuar, reporterët ndjeyen se s'mund ta kryejnë punën e tyre në mënyrë proaktive përkundër faktit se ata duan që të zhvillojnë hulumtime të detajizuara, të kërkojnë dhe ta informojnë opinionin publik se çfarë ngjan rreth tyre. Në përgjithësi, duhet bërë më shumë që të raportohen dhe hulumtohen shumë tema në Kosovë, por tema e trafikimit me qenie njerëzore është mjaft me rëndësi për t'u fokusuar.

Gjatë punëtorisë 'Mbulimi Medial i Trafikimit me Qenie Njerëzore' mbajtur në selinë kryesore të OSBE-së në Prishtinë, u shfaq një intervistë me një viktimë nga Shqipëria e cila ishte e detyruar në prostitucion të dhunshëm në Itali. Nga intervista u pa qartë se viktimat tani e kthyer në Shqipëri pas dhjetë vjetësh nuk mund të reinteegrohej përsëri në familje dhe shoqëri. Jeta i ishte shkatërruar, mirëpo asaj i kishte ndihmuar fakti se identiteti i saj ishte mbajtur i fshehtë. Ajo ishte në gjendje ta tregojë rrefërimin e saj duke mos menduar për



Laura Aviles (OSBE), Igballe Rexha (Qendra për Mbrojtjen e Grave e Femijëve) dhe Linda Karadaku (Zeri i Amerikës) gjatë një seminari mbi mbulimin e mediave trafikimin me njerëz

pasojat në të cilat ishte katandisur. Intervista shërbeu is mësim i mirë mediave kosovare dhe publikut në tërësi se këkohet më tepër ndjeshmëri kur të raportohet apo shqyrtohen tema që kanë të bëjnë me viktimat e trafikimit. Disa shikues kosovarë kanë mundësi të shohin se çfarë po ndodhë brenda dhe jashtë Kosovës sa i përket trafikimit. Është gjithashtu përgjegjësi e mediave ta fortësojnë pozitën e tyre në çështje të tilla.

Problemet paraqiten si pasojë e sistemeve ekonomike dhe arsimore në Kosovë. Përveç viktimave të trafikimit, shumë gra dhe femra të Kosovës merrin me prostitucion në mënyrë që të mbijetojnë. Statistikat tregojnë se më shumë se 50 për qind e popullatës së Kosovës është e papunë. Sipas Qendrës për Mbrojtjen e Grave dhe Femijëve, shumë prej këtyre viktimave kanë vetëm arsimim fillestar apo s'kanë fare edukim shkollor. Sigurisht se ekziston mungesa e të kuptuarit të trafikimit. Një viktimë e intervistuar prej kësaj qendre tha se "trafikimi" ka të bëjë me diçka si "dritat e

trafikut" apo "komunikacioni" në përgjithësi. Shumica e këtyre viktimave nuk kanë njohuri se çfarë ndodhë përreth tyre ndërherë pasi që të jenë kidnapuar dhe detyruar në prostitucion të dhunshëm.

Mediat kosovare mund të ndihmojnë më shumë duke marrë iniciativë dhe duke u fokusuar më shumë në çështjet e trafikimit me qenie njerëzore, në mënyrë që ta shtojnë këtë interes fundamental në media por edhe në popullatë.

Aq më shumë, rekomandimi më i mirë është që mekanizmat ligjore, policia dhe sistemet gjyqësore të japin sa më shumë nga vetja për ta çrrënjësuar trafikimin me qenie njerëzore në Kosovë në bashkëpunim dhe koordinim me vendet tjera fqinje që kanë dhe merrin me probleme të njëjta: anti-trafikim, identifikim, me asistim dhe rehabilitim të viktimave. Me zhvillimin e Kosovës, edhe mediat do të duhen të jenë më të përgjegjshme në raportimin e tyre për trafikimin me qenie njerëzore dhe ta rrisin numrin e temave të ngjashme në skemat e tyre programore.

Pjesëmarrësit dëgjojnë rekomandimet gjatë një konference mbi luftimin e trafikimit me njerëz



## Të ndërtojmë mbi projektin 'Thyerja e Murit'

Nga Afrore Çitaku

"Ishte një vizitë studimore ndër më produktivet deri më tani. Ne na u dha mundësia të mësojmë dhe pasurojmë njohuritë tona mbi qeverisjen lokale, se si ajo mund të funksionojë në mënyrë më të mirë dhe më të efektshme," tha Z. Skender Zogaj, kryetar i komunës së Fushë Kosovës, duke komentuar vizitën e fundit katër ditore në Norvegji.

Në këtë udhëtim Z. Zogajin e shoqëruan edhe kryetari i komunës së Dragashit, Z. Halim Shemsedini, së bashku me kryeshëfën e ekzekutivit, zonj. Radica Janiqeviq nga komuna e Shtërpçës, nga përfaqësues organizata të ndryshme joqeveritare dhe si dhe zyrtarët për informim publik të të tri komunave. Kjo vizitë ishte pjesë e projektit "Thyerja e Murit", projekt i departamentit për demokratizim.

Qëllimi i kësaj vizite studimore ishte që pjesëmarrësit të mund

të shkëmbejnë ide se si kuvendet komunale informojnë qytetarët e tyre, duke shkëmbyer përvoja dhe njohuri me institucionet homologe dhe asociacionet tjera në Norvegji. Theks i veçant i është kushtuar komunikimit dhe transparencës së kuvendeve komunale me qytetarët që si synim përfundimtar të ketë përmirësimin e shërbimeve komunale dhe bërjen e tyre sa më të afërta me qytetarët.

Grupit të Kosovës i'u dha mundësia të takohet me asociacionin norvegjez të autoriteteve lokale dhe regionale në qytetin e Oslos, dhe të mësojë mbi kyqjen e qytetarëve në qeverinë lokale norvegjeze, në veçanti në komunat Hamar, Stange dhe Loten. Ata gjithashtu u informuan mbi rolin që kanë zyrat për informim publik, si dhe mbi bashkëpunimin e të tri këtyre komunave me sektorin privat. Sfera të tjera që u diskutuan

gjatë vizitës ishin edhe procedurat standarde komunale mbi çështjet administrative dhe propozimet për këshillin komunal dhe bordin ekzekutiv, si dhe informimi mbi bashkëpunimin e tyre me organizatat joqeveritare.

"Proceset vendimarrëse në qeveritë lokale norvegjeze janë shumë të avansuara, krahasuar me ato tonat", theksoi Z. Zogaj. Ai gjithashtu theksoi se, "ndikimi i drejtpërdrejt i qytetarëve është shumë i fuqishëm dhe çka është më e rëndësishmja është se qytetari respektohet maksimalisht." Shumëçka është mësuar nga secili që pati mundësinë të marrë pjesë. Z. Zogaj na tregon më shumë për këtë: "Ne mësuar për mënyrat më të mira mbi menaxhimin e buxhetit komunal, dhe ajo çka na impresionoi më së tepër ishte bashkëpunimi shumë i ngushtë në mes të të gjithave partive

politike dhe devotshmëria e tyre për të punuar mbi bazën e vullnetit të qytetarëve të tyre."

Kjo vizitë pune nuk do të kishte ndodhur pa një bashkëpunim të mirë. Z. Tore Nilsen, shef i ekonomisë për komunën e Hamarit së bashku me qeverinë komunale organizuan këtë vizitë,

me përkrahjen e kryetarëve të komunave të Hamarit, Stanges and Lotenit dhe ministrisë për punëve të jashtme të Norvegjisë. Të gjithë pjesëmarrësit ndajnë të njëjtin mendim se kjo vizitë studimore u dha mundësi që të mësojnë shumë dhe për të gjithë ishte një rast i shkëlqyeshëm.

Grupi kosovarë që ishte për vizitë studimore në Norvegji



# Të jetojmë së bashku

Nga Nderim Pasuli

Pas perfundimit të konfliktit në Kosovë mungesa e komunikimit dhe besimit ndërmjet komuniteteve ka qenë pengesa kryesore për reintegrimin. Qytetarët e komuniteteve të ndryshme pothuajse nuk flisnin me njëri tjetrin. Për këtë arsye ishte më se e nevojshme që organizatat dhe institucione që verprojnë në Kosovë të iniconin takime të ndryshme, biseda të hapura dhe tryeza të rumbullakta. Për këtë qëllim, një sërë tryezash të rumbullakëta të pagëzuar "Të jetojmë së bashku" janë mbajtur në rajonin e Prizrenit në bashkëpunim me OSBE-në, UNHCR-in, Komitetin Katolik Ndërkombëtar për Migrim (KK-NM) dhe Pax Christi/Forum (CPS).

Sesioni i fundit i radhës është mbajtur në Radio "Vala 2000"

të Suharekës. Pjesëmarrës ishin kryeshefat ekzekutiv të komunave të Prizrenit, Suharekës, Rahovecit, Dragashit dhe Shtërpcës.

Në përgjithësi mund ta konsiderojmë këtë sesion si më të suksesshmin sepse pjesëmarrësit ishin mjaft konkret duke u përputhur bisedat e tyre me temën aktuale. Të gjithë e mbështesnin procesin e kthimit dhe prezentuan fakte konkrete për punën e tyre të bërë si udhëheqës të qeverive komunale. "Pra, ne vazhdojmë të mbështesim përfundimin e administratës komunale dhe të senzibilizojmë qytetarët për politikën aktuale të qeverisjes lokale për procesin e kthimit dhe të reintegrimin" tha Vasilios Tagios, zyrtar për demokratizim në zyrën e OSBE-së në Prizren.

Të gjithë pjesëmarrësit janë pajtuar se procesi i kthimit nuk duhet të politizohet dhe se qeveritë lokale duhet fuqimisht të mbështesin këtë proces dhe të krijojnë kushte elementare për kthim dhe integrim.

"Nuk është lehtë të jetohet në ekzil, ose si një i shpërngulur. Kosova është një vend demokratik dhe ofron kushte të volitshme për kthim. Mirëpo nuk mund ti injorojmë edhe problemet me të cilat ballafaqohen këta njerëz, tha Ragip Gajraku, kryeshef ekzekutiv i kuvendit komunal të Prizrenit.

Pasojat e të jetuarit në ekzil janë mëse evidente për shumicën e refugjatëve, prandaj ndërtimi i shtëpive është kushit vendimtar për kthim. "Procesi i kthimit nuk është i lehtë, është një maraton e

vërtetë, por ne kemi ndërmarrë hapa konkret. Komunitetet janë integruar në institucionet tona. Kemi plane konkrete për ndërtimin e objekteve afariste që do të mundësojnë punësimin e qytetarëve të komuniteteve", tha Ibrahim Kryeziu, kryeshef ekzekutiv i kuvendit komunal të Rahovecit.

Debatet publike, tryezat e rumbullakëta dhe bisedat e përditshme janë të nevojshme për ngritjen e vetëdijës qytetare, në mënyrë që të kuptohen më mirë problemet me të cilat ballafaqohen të zhvendosurit për çdo ditë. Debatet "Të jetojmë së bashku" janë vetëm një nga format për ta ndihmuar një proces më të lehtë kthimi, duke inkurajuar bisedat dhe një vetëdijësimin qytetar.

"Procesi i kthimit të Shqiptarëve në komunën e Shtërpcës është pothuajse i kryer. Kanë mbetur edhe disa çështje teknike në lidhje me riparimin e shtëpive të të kthyerëve. Ajo që inkurajon është se komunitetet kanë pranuar njeri tjetrin", tha Spomenka Kojadinovic, ushtruese e detyrës së kryeshefit ekzekutiv në Shtërpcë.

Në fund të gjithë pjesëmarrësit u pajtuan se dialogjet, bisedat, debatet publike, tryezat e rumbullakëta dhe kontaktet e përditshme janë të nevojshme për të ngritur vetëdijen e qytetarëve për të kuptuar njeri tjetrin dhe hallat e përditshme me të cilat ata ballafaqohen. Nga ana tjetër me mbështetjen e institucioneve qendrore, lokale dhe faktorit ndërkombëtar këto probleme do të tejkalohen më lehtë.

## Shkollim të barabartë për romë, ashkalinjë dhe egjiptas

Nga Mervlyde Salihu

Sot komuniteti rom, ashkali dhe egjiptas (RAE) janë në një situatë të vështirë sociale, shkollimi është njëra prej arsyeve për këtë gjendje. Fëmijët e këtyre komuniteteve shihen shumë më shpesh në rrugë se sa në shkolla, por edhe ata që vijnë në shkollë, shpesh e braktisin atë. OSBE-ja dhe Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) vendosën ta adresojnë këtë problem. Në të shumtën e rasteve, vijimi i dobët në shkollë nga fëmijët e RAE komuniteteve është për shkak të parave ose transportit, ose për shkak se prindërit e nënvlerësojnë rëndësinë e shkollimit. Në të vërtetë, trajnimi diskriminues ose prob-

lemet gjuhësore shpesh çojnë drejt braktisjes së shkollës nga ata fëmijë që vijnë në mësimin.

Me qëllim të ndryshimit të kësaj situatë të vështirë, OSBE-ja dhe MASHT-i kanë organizuar tryeza të rumbullakëta rajonale, me qëllim të identifikimit të çështjeve kryesore dhe mënyrat për zgjidhjen e tyre. Rexhep Osmani, Ministër i Arsimit, në një konferencë për shtyp tha se MASHT-i është i angazhuar të përmirësojë përgaditjen shkollore të këtyre komuniteteve.

"Kemi të dhëna se 1,600 fëmijë nga këto tri komunitete tani marrin pjesë në një program të përsheptuar, i cili është duke u zhvilluar në 12 komuna" - tha

Osmani. "Një ndër prioritetet e identifikuar është përfshirja e gjuhës, historisë dhe kulturës së tyre në shkollat", shtoi ai. Ministria e Arsimit dhe OSBE-ja do të formojnë një grup punues për të shqyrtuar realizueshmërinë e kësaj.

Gianfranco D'Eramo, zyrtar i Departamentit për Demokratizim pranë OSBE-së, tha "nëse rekomandimet përbushen, programi mund të shtojë regjistrimin e fëmijëve nga këto komunitete deri në 40% në vitin e ri shkollor." Shihet qartë se programi i përsheptuar është i rëndësishëm për përmirësimin e përcjndjes së vijimit të shkollës dhe shkollimit në përgjithësi.

## Modeli i konferencës së OKB-së në Lipjan

Nga Berat Reçica



Të rinjtë duke votuar në konferencën, 'Modeli i OKB-së' mbajtur në Lipjan

Tema e 'Modelit të Konferencës së Kombeve të Bashkuara' (MKKB) të mbajtur kohëve të fundit dhe organizuar nga departamenti për demokratizim të OSBE-së në Lipjan, ishte 'Trafikimi i Njerëzëve', e cila çështje çdo vit po bëhet më e rëndësishme.

Qëllimi i përgjithshëm i këtij sesiioni të MKKB ishte që t'u ofronte nxënëseve të shkollës së mesme, shqiptarë, sërë dhe ashkali të Kosovës në komunën e Lipjanit mundësi për të marrë pjesë në programin për pajtimin e grupeve të përziera etnike. Arta Uka, një pjesëmarrëse, shpjegon: "MKKB-ja ndihmon minoritetet të integrohen në jetën e përditshme, të takojnë njerëzit tjerë dhe të komunikojnë në një gjuhë alternative, në këtë rast në gjuhën angleze."

Programi ofron mbikëqyrje rekrutative dhe aktivitete joformale për ndërtimin e tolerancës, në një ambient pozitiv dhe sfidues për zhvillimin shoqëror, fizik, mental dhe emocional të të rinjve.

Ky ishte programi i parë pas konfliktit që i bashkon të rinjtë nga komunitetet e ndryshme," na tregoi pjesëmarrësi tjetër Milenko Bilibajkiq, "ne kemi diskutuar gjatë për temat kryesore, për shembëll: AIDS; riatdhësimin e refugjatëve; për drogën

dhe narkotikët; administratën e re të përkohshme në Irak; konfliktin në mes Izraelit dhe Palestinës dhe trafikimin e njerëz," konkludoi ai. Më e rëndësishmja është se këto çështje janë duke u diskutuar së bashku, pa marrë parasysh se kush ishte ulur pranë kujtë. Të gjithë pjesëmarrësit janë munduar shumë që ta vënë veten në këpucët e tjetrit për të kuptuar perspektivat e ndryshme.

Gjatë këtij programi, pjesëmarrësit ishin inkurajuar të formojnë rrjetin e vet për mbështetje dhe mekanizma, në mënyrë që të mbajnë kontakt me të rinjtë tjerë banor të kësaj komune. Me të vërtetë në këtë vend janë krijuar raporte në mes të komuniteteve dhe grupeve etnike. Shumë të rinjtë sërë dhe ashkali e ndjejnë veten të lirë që të hyjnë në qendër dhe të marrin pjesë në aktivitete. Kjo nuk ka ndodhë përpara.

OSBE-ja shpreson të vazhdojë programin gjatë vitit 2004 me qëllim të implementimit të "Modelit të Konferencës së Kombeve të Bashkuara" në mbarë Kosovën. Deri tash ky ka qenë një mjet i rëndësishëm për pajtim. Plani i ardhshëm është të koncentrohemi më shumë në punën cilësore pasi që anëtarët do të fitojnë më shumë përvojë.



Z. Lindholm zëdhënës i OSBE-së, z. Frishenslager, drejtor i departamentit për demokratizim në OSBE dhe z. Osmani, ministër i arsimit